

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në botë

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut 30.12.2024 -05.01.2025

Janë testuar gjithsej 219 materiale në Laboratorët ku bëhen analiza molekulare për vërtetimin e pranisë së virusit SARS-CoV-2. Krahasuar me javën që shkoi (n=128) është shënuar një rritje prej 71,1%.

Nuk janë regjistruar raste pozitive.

Tabela 1. Numri i testimeve dhe rasteve pozitive në periudhën nga 30.12.2024-05.01.2025

Data	Testime	Pozitive	% e rasteve pozitive
30.12.2024	31	0	0,0%
31.12.2024	22	1	4,5%
01.01.2025	1	0	0,0%
02.01.2025	50	2	4,0%
03.01.2025	34	2	5,9%
04.01.2025	37	1	2,7%
05.01.2025	44	0	0,0%
Gjithsej	219	6	Mesatarja 2,4%

Gjatë javës së kaluar (30.12.2024 - 05.01.2025) janë regjistruar si të shëruar 3 persona, ndërkohë që nuk është raportuar rast i vdekjes si pasojë e COVID-19.

GJENDJA KUMULATIVE ME COVID-19 NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Gjatë vitit 2024/25, deri më 05.01.2025, janë regjistruar gjithsej 1.755 raste me COVID-19. Në muajin dhjetor të vitit 2024 (6) regjistrohet një rënie prej 50% për dallim nga një muaj më parë.

Gjatë vitit 2024/25, deri më 05.01.2025, janë testuar gjithsej 13.510 materiale, në laboratorët në të cilët realizohen testime molekulare për prani të SARS-CoV-2 dhe në laboratorët / institucionet shëndetësore në të cilat bëhen testimet e shpejta antigjene.

Vlerësimi i rrezikut

Shkalla e ulët e transmetimit të SARS-CoV-2, rënia e numrit të raportimeve dhe testimeve ndikon në aftësinë për vlerësimin e gjendjes epidemiologjike. Popullata e EU/EEA në përgjithësi ka një nivel të konsiderueshëm të imunitetit hibrid (vaksinim/vaksinim me booster doza), që ofron një mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes.

Personat mbi 60 vjet janë më të rrezikuar nga pasqyra e rëndë e sëmundjes.

Hospitalizimi i personave me COVID-19 të konfirmuar, pranimet në kujdesin intensiv dhe vdekjet mbeten në nivel të ulët në vendet e BE-së. Këto të dhëna nuk janë të disponueshme në R. e Maqedonisë së Veriut.

Edhe pse numri i të sëmurëve me COVID-19 në javë po shënon rënie, duke pasur parasysh se fillon periudha e qarkullimit të shtuar të viruseve respiratore në hemisferën veriore, ekziston rreziku që aktiviteti i SARS-CoV-2 të rritet, gjë që e thekson nevojën e vazhdueshme për mbikëqyrje (epidemiologjike dhe virologjike) në nivel kombëtar dhe rajonal.

Masa të rekomanduara për parandalim dhe kontroll

Rekomandohet ndjekja e masave themelore për parandalimin e COVID-19 dhe sëmundjeve të tjera respiratore.

Vaksinimi mbetet si masë specifike që mundëson mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes, edhe pse ky efekt mbrojtës me kalimin e kohës dobësohet. Mbetet rekomandimi për vaksinimin e personave me rrezik të lartë nga format e rënda të sëmundjes (siç janë personat më të moshuar).¹

Shkup, 08.01.2025

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse

Instituti i Shëndetit Publik

¹ <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/2024-WCP-0039%20Final.pdf>